

STATISTIKAT ZYRTARE GJATË TRANSFORMIMEVE
DEMOKRATIKE

Milva Ekonomi
Drejtore i përgjithshëm, INSTAT

1. HYRJE: DISA KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Tashmë është bërë e qartë se statistikat zyrtare në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit kanë ndryshuar. Në një shoqëri, që ka filluar të hapet drejt informacionit, ndryshimet në sistemin statistikor kombëtar shqiptar lidhen me ndryshimin e konceptimit të rolit të statistikës. Në këtë kuadër, këto ndryshime janë më të thella se sa ndryshimet në metodat dhe teknikat statistikore.

Gjatë këtij evoluimi gjëja e parë, që bie në sy është që, dhe pse ka një rritje të vazhdueshme të kërkesës për informacion statistikor, ka ulje të ndjeshme të burimeve, që e prodhojnë atë. Kjo është përcaktuar, jo vetëm nga burimet e vështira dhe të pakta financiare të destinuara për administratën publike, por edhe nga fakti se shoqëria filloi të jetojë mes një sasive informacioni me të cilin nuk ishte mësuar më parë. Të dy këta faktorë janë bërë pengesë për të kuptuar rolin e pazëvendësueshëm të statistikës zyrtare në një shoqëri, që po transformohet.

Nga ana tjetër, ndryshimet politike që kalon vendi kanë një ndikim të rëndësishëm mbi statistikën. Ndryshimet politike kanë qenë tronditëse, pothuajse si një tërmet, për sistemin statistikor kombëtar. Si ta kuptojmë këtë? Gjatë sistemit diktatorial statistika kombëtare ishte një ndjekëse e detyruar e objektivave ekonomike të partisë në pushtet.

Ajo ndiqte zbatimin e detyrave sasiore të planit dhe këtë e bënte në mënyrë të detyrueshme mbi bazën e një raportimi vertikal nga "poshtë-lart" për çdo muaj, tremujor dhe vit. Heqja e detyrimit të planifikimit dhe coptimi i ndërmarrjeve ekonomike si rezultat i privatizimit, eliminuan edhe këtë detyrim të ndërmarrjes.

Më tej, një pjesë e treguesve statistikorë socialë ishin fare të panjohur për shoqërinë e kohës, të tillë si papunësia apo varfëria. Demagogjia politike e pushtetit nuk i pranonte ata as si shprehje gjuhësore. Asokohe nuk mund të mendohej të llogaritej indeksi i çmimeve të konsumit! Çmimet ishin të kontrolluara dhe ndryshonin vetëm me vendime politike.

Ajo që kemi kuptuar, megjithatë, në këto gati 10 vjet, është se gjatë procesit të tranzicionit, jo të gjithë treguesit statistikorë ndryshojnë dhe përmirësojnë cilësinë e tyre. Në këtë kuptim, ka një debat të vazhdueshëm mbi plotshmërinë ose jo të asaj që bëhet në të kaluarën dhe paplotshmërinë e asaj që bëhet sot. Përkrah statistikave zyrtare në këtë debat, të vetmit që dalin në mbrojtje në këtë moment specifik të zhvillimit, janë akademikët. Kjo, sepse ata janë në pararojë të njohurive empirike të shkollës së re të statistikës praktike dhe e ndjejnë nevojën e aplikimit të saj.

Një rol të padiskutueshëm në këtë proces ndryshimesh luan edhe komuniteti i institucioneve ndërkombëtare të instaluar në vend. Duhet të themi se jo në të gjitha rastet prania e tyre është ndihmëse, por, gjithësesi, ato janë mbështetëset dhe frymëzueset e projekteve më të mëdha të zhvillimit. Me asistencën e tyre teknike ato shpesh bëhen garantuese të cilësisë së treguesve statistikorë, por, ndodh që edhe mbështetja e vazhdueshme të mos lejojë një vetëveprim në rritje.

Pavarësisht nga të gjitha llojet e vështirësive, të përmendura ose jo këtu më lart, që kalon të kuptuarit e rolit të statistikës në një shoqëri të re demokratike, një gjë është shumë e qartë: roli i statistikës zyrtare ka filluar të bëhet më i dukshëm. Statistikat fillojnë të kuptohen e të pranohen si elemente bazë në vendimarrje. Përdoruesit kryesorë të tyre janë vërtet institucionet publike dhe sidomos qeveria, por sa më shumë zgjerohet procesi i vendimarrjes aq më shumë shtohet edhe numri i përdoruesve të statistikës. Me fjalë të tjera, sa më shumë demokratike bëhet shoqëria, aq më shumë rritet roli i statistikës në shoqëri.

2. BESIMI NË STATISTIKAT ZYRTARE

Kur shoqëria lëviz drejt një sistemi demokratik, roli i statistikës zyrtare nuk është vetëm të ndihmojë politikëbërësit në marrjen e vendimeve, por sidomos të informojë shoqërinë mbi veten e saj. Ajo u sjell të gjitha subjekteve, ekonomike ose jo, financiare ose jo, informacionin për të cilin ato kanë nevojë. Kjo do të thotë që roli i statistikës ndryshon duke kaluar nga një shërbim qeveritar në një shërbim publik. Ky ndryshim shoqërohet edhe me rritjen e detyrimeve nga të gjitha palët. Që nga momenti që statistika merr përsipër të informojë për atë ç'ka ndodhur me anë të të dhënave të kuptueshme për secilin

përdorues, ajo nuk duhet të harrojë, për asnjë çast, që luan një rol të rëndësishëm në jetën e gjithësecilit.

Vrojtimet statistikore të kryera nëpërmjet intervistave ballë për ballë, kërkojnë, që në fillim, vendosjen e një vije veprimi dyobjektivëshe: së pari, të garantosh se informacioni që i merret subjektit është **konfidencial** dhe do të përdoret vetëm për qëllime statistikore, dhe së dyti që të dhënat do të jenë **neutrale**. Kjo kërkon që zyrat e statistikës të ngrenë një strategji të tërë për të bërë të shpjegueshëm konfidencialitetin. Procesi bëhet i vështirë, nisur dhe nga fakti se nuk janë vetëm njësitë statistikore që punojnë me subjektet. Nga ana tjetër, në një realitet ku jo shumë kohë më parë çdo gjë ka qenë e kontrolluar nga shteti, bashkëpunimi i sotëm i subjekteve me institucionet publike të çfarëdolloji, shihet me shumë dyshim nga subjektet duke u dhënë institucioneve një besim të kontrolluar.

Dhënia e çdo informacioni është, para së gjithash, shprehje e besimit dhe e gadishmërisë, e civilizimit dhe e aftësisë për të kuptuar se këto statistika do t'u shërbejnë më së pari informaciondhënësve. Sa më shumë të rritet korrektësia dhe saktësia në përgjigje, aq më shumë statistikat shndërrohen në mjete të rëndësishme informimi për ata vetë.

Në këtë kuadër, zyrat e statistikës duhen të vendosin një përdorim të barabartë të të dhënave nga të gjithë përdoruesit. Kjo detyrë nuk kufizohet vetëm në dhënien e aksesit, por edhe në shpjegimin e vazhdueshëm të treguesve dhe kuptimin e vërtetë ekonomik dhe social të tyre.

3. LIGJI PËR STATISTIKEN: A E LUAN AI PLOTËSISHT ROLIN QË DUHET?

Përpara se t'i përgjigjemi kësaj pyetje le të japim një kuadër historik të momentit kur u hartua dhe u miratua ky ligj.

- Ligji mban datën 16 mars 1993. Ndryshimet e sistemit ekonomik ishin shumë të shpejta dhe nevoja për monitorimin e tyre bëhej imediate.
- Ndjehej nevoja e një baze legjislative të përgjithshme me qëllim që të mbështeteshin operacionet statistikore të mëtejshme sipas eksperiencës, që do të mblidhej.
- Çdo hap konsultohet me ekspertët, që mbështetnin vendimet mbi stabilitetin makroekonomik.
- Në Divisionin e Statistikës të Kombeve të Bashkuara akoma nuk kishin dalë Parimet Themelore të Statistikës.
- Nuk kishte eksperiencë të ngjashme legjislative në këtë fushë nga sistemi ekonomik-politik i kaluar.

Natyrshëm, pyetjes a i shërben ky ligj statistikës së sotme, në përgjithësi, do t'i përgjigjeshim: **DUHET PËRMIRËSUAR**. Nevoja për një përmirësim të ligjit për statistikën rrjedh nga fakti se, përveç bazës ligjore konform ndryshimeve ekonomike që ka kaluar vendi, duhet të adoptohen edhe Principet Themelore të Statistikës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1994.

Procesi i fuqizimit të bazës legjislative të veprimtarisë statistikore të INSTAT duhet shoqëruar, domosdoshmërisht, edhe me një paketë rregullatore, si vendime të Këshillit të Ministrave, ose udhëzime, të cilat duhet të jenë plotësisht të zbatueshme nga të gjitha subjektet, që duhet të furnizojnë me informacion rutinën statistikore. Nga këto subjekte kërkohet një angazhim tërësor, brenda veprimtarisë së gjithësecilit, për të kuptuar dhe për të përhapur këto vendime ose udhëzime.

Gjithashtu, në ligjin e përmirësuar duhet të zërë një vend të posaçëm programi afatgjatë i veprimtarisë statistikore të INSTAT dhe angazhimi financiar, që duhet të rrjedhë prej tij. Është shumë e vështirë të kërkosh realizim cilësor të statistikës pa i vënë asaj në dispozicion kushtet më të domosdoshme. Duhet të theksohet nevoja për një financim të vazhdueshëm dhe në rritje, në përputhje me Master Planin e paraqitur nga INSTAT, pranë Këshillit të Ministrave. Krahasimi midis burimeve, që angazhonte statistika në të kaluarën edhe sot mund të bëhet vetëm përsa i përket burimeve njerëzore (në të kaluarën ishin më shumë). Lidhur me burimet financiare, natyrshëm, angazhimet duhen të jenë të tjera dhe më të mëdha.

Ligji i përmirësuar i statistikës duhet të marrë në konsideratë edhe ndryshimet e rolit të ri të punonjësve të statistikës, të cilët u shërbejnë më shumë kërkimeve statistikore se sa më parë. Vështirësitë e mbledhjes së informacionit dhe shkalla cilësore e përgjigjes, detyrojnë njohjen e teknikave të tjera të përpunimit. Kultura kombëtare statistikore, e cila për hatër të së vërtetës lë për të dëshiruar, duhet përhapur me qëllim që t'i shërbejë misionit që ka statistika.

Duhet punuar që të kuptohet nga të gjithë se ajo është një e mirë publike që, jep në të mirë të të gjithëve, një panoramë socio-ekonomike, si dhe tendencat e zhvillimit për vendin në tërësi dhe rajonet e veçanta të tij.

4. ROLI I RI I STATISTICIENËVE NË PROCESIN E TRANSFORMIMIT TË SHËRBIMIT STATISTIKOR

Në vendet si Shqipëria, ku demokracia është ende e brishtë dhe roli i ri shtetit ende nuk kuptohet mirë, bëhet shumë i vështirë respektimi i pavarësisë së zyrës së statistikave, edhe pse kjo pavarësi është e dhënë në ligjin për statistikën. E parë kjo në syrin e shoqërisë shqiptare, asgjë e pazakontë nuk ndodh, por për vetë punonjësit e statistikës ka një konsumim profesional të vazhdueshëm.

Zyra e statistikës, e cila ka përgjegjësinë profesionale të ngrejë dhe të përgjigjet për cilësinë e mjeteve të tilla si, regjistri i ndërmarrjeve, nomeklatuarat, kartografia, regjistri i njësive ekonomike bujqësore, etj., në kushtet tona nuk pushon së vepruari deri këtu. Informacioni, që duhet të mblidhet mbetet objekt i vendimmarrjes së saj. Përdoruesit ende nuk janë në gjendje të vendosin prioritetet. Për këtë arsye, statisticienët, jo vetëm që merren me konsolidimin e mjeteve të statistikës, por edhe vendosin se ç'duhet të kërkojnë nga subjektet.

Vetë statisticienët përballin një kërkesë në rritje dhe një shndërrim gradual të dijeve të tyre të marra gjatë sistemit ekonomik të centralizuar. Ata duhet të përvetësojnë jo vetëm teknikat e reja të vërtetimit, por edhe njohjen e subjekteve të informacionit. Për shembull, vërtetimet pranë familjeve kanë qenë aktivitete të panjohura më parë. Përveç faktit që ballafaqoheshin me një vërtetim, statisticienët duhej të përgatitnin edhe opinionin që të perceptonte familjen si “një njësi ekonomike që merr vendime”.

Nga ana tjetër, një administratë publike e paqëndrueshme, e cila nuk mbron punonjësit e vet, jo vetëm që krijonte një imazh të keq në publik në përgjithësi, por nuk lejonte forcimin e dijeve dhe transmetimin e vazhdueshëm të tyre. Në përgjithësi, INSTAT ka patur një tjetër ecuri, pak gjëra ndryshuan brenda tij si rezultat i ndryshimeve në administratën publike. Megjithatë, nuk duhet harruar se në ambientin e bashkëpunëtorëve të vet çdo gjë lëvizte dhe ndryshonte pa fund.

Disa nga punët më të rëndësishme statistikore të INSTAT janë:

- Në vitin 1994 u krijua regjistri i ndërmarrjeve ekonomike, i cili është mjeti më i rëndësishëm dhe i padiskutueshëm, që mundëson grumbullimin e informacionit ekonomik. Për ndërtimin dhe përditësimin e regjistrit të ndërmarrjeve, INSTAT mbështetet në rekomandimet e EUROSTAT-t (Council Regulation EEC nr 696/93 of 15 March 1993 on the statistical units and Council EEC nr 2186/93 of July 1993 on Community coordination in drawing up business registers) dhe rezultatet e të gjitha anketave ekonomike statistikore të kryera nga INSTAT. Procedura e përditësimit mbështetet, gjithashtu, në rekomandimet e EUROSTAT. Mbështetur në të dhënat e regjistrit të ndërmarrjeve INSTAT publikon përmbljedhjen statistikore ‘Ndërmarrjet sipas prefekturave me bazë vjetore’. Krahas publikimeve periodike INSTAT publikon botime speciale mbështetur në rezultatet e projekteve PANEL PECO dhe DOSME.
- Në vitin 1995 bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave u legalizua dhe filloi aplikimi i nomenklaturës së klasifikimit të aktiviteteve ekonomike, NACE, Rev.1, për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare, që lidhen me ndërmarrjet në *business register*. Instituti i statistikave modifikon dhe zbaton nomenklaturën standarde ndërkombëtare të klasifikimit social dhe ekonomik.
- Anketa e kushteve të jetesës dhe anketa e buxhetit të familjes. Anketa e kushteve të jetesës mbështetet në metodologjinë e Panelit Europian të Familjeve (ECHP) dhe përshtetet në kushtet e vendit. Temat, që studion kjo anketë janë : situata demografike, punësimi, emigracioni, lëvizjet e brendshme të popullsisë, kushtet e banimit dhe të jetesës, të ardhurat familjare. Në klasifikimin e profesioneve përdor Klasifikimin Ndërkombëtar të Profesioneve ISCO-88 dhe NACE-1 për klasifikimin e aktivitetit të ndërmarrjeve.
- Anketa e buxhetit të familjeve mbështetet në metodologjinë dhe rekomandimet e EUROSTAT mbi anketat e buxhetit të familjes. Në përputhje me rekomandimet për harmonizimin e treguesve të kësaj ankete është adoptuar nomenklatura e produkteve COICOP-PROCOME HBS versioni i fundit. Në klasifikimin e profesioneve përdor klasifikimin ndërkombëtar të profesioneve ISCO-88.
- Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore. Ky regjistrim u realizua me mbështetjen teknike të ISTAT-it Itali dhe EUROSTAT-it.

- Llogaritja e Indeksit të çmimeve të konsumit (mujore).
- Llogaritja e indeksit të kostos në ndërtim (tremujore).
- Llogaritja e indeksit të shifrës së afarizmit në tregtinë me pakicë (tremujore).
- Llogaritja e indeksit të vlerës njësi në tregtinë e jashtme (tremujore).
- Anketa vjetore strukturore pranë ndërmarrjeve ekonomike. Realizimi i kësaj ankete mbështetet në rekomandimet e EUROSTAT-it Council Regulation (EC, EURATOM) nr. 58/97, datë 20 dhjetor 1996 dhe nr. 410/98, datë 16 shkurt 1998 në lidhje me *structural businesses statistics*, dhe 'Council Regulation no. 1165/98, datë 19 maj 1998 concerning short-term statistics'.
- Përmirësimi i sistemit të llogarive kombëtare dhe llogaritja e treguesve makroekonomikë si PBB, sipas rekomandimeve të lëna nga FMN.
- Ndjekja e informacioneve statistikore sipas programit kombëtar statistikor të aprovuar, sipas përkatësive të Ministrive.

Objektivi kryesor i INSTAT është realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave në vitin 2001.

Gjatë këtyre viteve të rritjes dhe përmirësimit të statisticienëve, vihet re një tendencë për të shpallur metodikën e ndjekur në llogaritjen e një treguesi të caktuar. Natyrisht që kjo ndodh kur arrihet një pjekuri profesionale e caktuar dhe jo të gjithë janë gati të bëjnë këtë. Treguesit më të qëndrueshëm dhe më afatgjatë janë tashmë të shpallur në treg. Nga ana tjetër, publikimi i metodikës kërkon mirëmbajtjen dhe përsosjen e vazhdueshme të saj nga vetë specialistët, të cilët janë konsoliduar tashmë në profesion dhe paraqiten me një seriozitet më të madh dhe më dinjitozë. Për më tepër, është ende e vështirë në shoqërinë e sotme shqiptare që misioni i statisticienit të kuptohet, jo vetëm si një mision në fushën publike, por edhe në atë të kërkimit shkencor. Ndodh që metodikat e publikuara nuk janë objekt i debateve profesionale, por më shumë objekt i debateve politike. Në këto kushte është e rëndësishme që kjo situatë të përballet me profesionalizëm. Statisticienët e ndjejnë se është e rëndësishme të fitohet kjo betejë në mënyrë që ta ndjejnë veten më të pavarur dhe më të vlefshëm ndaj shoqërisë.

Publikimi, në vitin 1998, për herë të parë, i një kalendari të shpallur mbi publikimet e vitit, ndihmoi që përdoruesit të orientoheshin më mirë rreth treguesve, që do të dilnin gjatë vitit dhe të mësoheshin me faktin se për të kuptuar se çfarë bën INSTAT ka disa pyetje që duhen bërë. Këto situata, që njëkohësisht favorizuan median për marrjen e informacionit, nuk mund të mos vendosnin kërkesa më të larta profesionale për statisticienët.

5. SI TË MARRIM INFORMACIONIN?

Kjo pyetje do të mbetet e vështirë edhe për disa vjet. Mbase jo për faktin se nuk dihet burimi i informacionit, por më shumë se si ta përdorësh atë dhe ta bësh bashkëpunëtor.

Ndryshimet ekonomike dhe rikrijimi i sektorit privat lëkundën bazën e të dhënave administrative dhe e bënë krejt të pavlefshëm programin statistikor kombëtar ekzistues. Forcimi i bazës së të dhënave administrative nuk ishte detyrë e drejtpërdrejtë e INSTAT, megjithëse ai bëri dhe vazhdon të bëjë presion të madh pranë enteve të caktuara, që duhet të furnizojnë me të dhëna këtë bazë. Detyra e menjëhershme e INSTAT ishte vendosja e një programi statistikor kombëtar të tillë, që të monitorohej reforma ekonomike që kishte filluar. Edhe sot, që kanë kaluar disa vjet nga fillimi i kësaj pune, programi kombëtar statistikor nuk është plotësisht i aftë të sjellë me shifra atë ç'ka ndodh realisht në jetën ekonomiko-sociale të vendit.

Kuadri, që kemi ndërtuar ka nevojë të përsoset vazhdimisht. Ai, sigurisht që do të reflektojë historinë, kulturën dhe përmbajtjen e vendit, por, gjithësesi, duhet të arrijë të jetë përdorues i praktikave më të mira metodologjike të aplikuara. Është detyrë e statisticienëve të sotëm shqiptarë, të bëjnë të lexueshëm për ambjentet jashtë vendit informacionin e mbledhur. Kjo kërkon një angazhim në zgjedhjen dhe në përdorimin e nomenklaturave bashkëkohore, koncepteve dhe definicioneve të standardizuara, por të vendosura këto në realitetin ekonomik dhe social të Shqipërisë. Praktikë kombëtare të deritanishme tregojnë se duhet punuar shumë për këtë. Jo vetëm që të zgjedhësh dhe të përshtatësh definicionet, standardet, konceptet, por për një shoqëri që lëviz e ndryshon kaq shpejt, duhet të bësh përshtatje të

vazhdueshme. Debatet profesionale rreth këtij problemi janë shumë të rëndësishme, por të rëndësishme bëhen edhe subjektet informuese, të cilat duhet të lehtësohen nga ngarkesat e shumta që të kenë mundësi t'u përgjigjen drejt dhe në kohë pyetjeve që bën statistika.

Në këtë kuptim, hartimi i pyetësorëve të kuptueshëm dhe marrëveshjet me ente të tjera administrative, me qëllim që të mos ngarkohen subjektet me kërkesa të pafund, janë kthyer në një objektiv profesional të punës së statistikienëve.

Janë vënë re disa përpjekje të para për të përdorur të dhënat administrative për qëllime të informimit statistikor. Kjo praktikë, mbetet një rrugë e vështirë përderisa ende nuk kuptohet drejt nga të gjithë se INSTAT ka një rol parësor në mbrojtje të konfidencialitetit të të dhënave individuale. Në këto kushte, nuk mund të lësh pa përmendur edhe faktin tjetër se zotërimi i një informacioni të caktuar dhe ruajtja me fanatizëm i tij mbetet një koncept i trashëguar në shoqërinë shqiptare, i cili shumë herë është pengues.

6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE STATISTIKORE

Shpërndarja e të dhënave statistikore zë një vend të rëndësishëm në aktivitetet e statistikave. Ajo ndihmon në krijimin e një imazhi të domosdoshëm në publik mbi dobishmërinë, cilësinë dhe objektivitetin e informacionit statistikor.

Sipas anketave të zhvilluara, shqiptarët janë më të ndjeshëm ndaj mediave se sa vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore. Në përgjithësi, shtypi shqiptar, televizioni dhe radio kanë luajtur një rol në rritje në shpërndarjen e të dhënave statistikore. Qëllimi ynë është që informacioni i prodhuar të jetë sa më i kuptueshëm dhe i besueshëm për lexuesin.

E gjitha kjo do të thotë që procesi i rritjes profesionale të statistikienëve, të marrë në konsideratë edhe trajnime dhe ballafaqime të vazhdueshme me gazetarët. Procesi i të kuptuarit të informacionit statistikor nga media e shkruar kërkon që INSTAT të ndërtojë një politikë të përshtatshme (*custom-tailored*), ku klienti gazetar jo vetëm të kuptojë, por të ndërtojë me statistikat marrëdhënie të drejta profesionale.

Në këtë përpjekje INSTAT duhet të respektojë afatin e shpallur për prodhimin e një treguesi të caktuar dhe, pavarësisht nga vështiresitë, duhet ta realizojë atë.

Sistemi i shpërndarjes së të dhënave, aktualisht, po kalon nëpërmjet një sërë ndryshimesh të diktuar nga zhvillimet më të fundit të teknologjisë. INSTAT ende përdor, kryesisht, metodën e trashëguar të publikimeve të printuara.

Këto metoda në çdo ditë që shkon nuk mund t'i përshtaten kërkesave të ndryshme si – të dhëna që mund të përpunohen direkt nga kompjuteri, - volume të mëdha për përpunime të pavarura të informacioneve të ndryshme, - furnizim i shpejtë me të dhëna, - bazë të dhënash për përdorim të pavarur, etj..

Ndryshimet teknologjike tentojnë të ndryshojnë formën klasike të shpërndarjes. Përpjekja për të mundësuar përdorimin e teknologjisë bashkëkohore po tenton, gjithnjë e më shumë t'u japë përdoruesve hapësirë të re për informacionin e kërkuar.

Në këto kushte, INSTAT po përballet me faktin se në ditët e sotme ka një rritje të shpejtë të përdoruesve të kompjuterit. Kjo rritje ka çuar edhe në rritjen e kërkesave për *hardware* të lehtë në përdorim dhe për softet të përshtatshme për të plotësuar nevojat e përdoruesve. Në kuadrin e rritjes së përpjekjeve për të modernizuar shpërndarjen e informacionit edhe INSTAT shërbehet nga INTERNET.

Elemente të ndryshme informative mbi përdoruesit kanë filluar të mblidhen lehtë përmes rrjetit. Sidomos, fjala është për shfrytëzimin e mesazheve elektronike ose të vjetarëve.

Për të ardhmen, është menduar të futet shpërndarja e informacionit statistikor me mjete standarde si disketë, CD, etj.. Nga ana tjetër, për përdorim final të të dhënave do të realizohen nga INSTAT kanalet, që u lejojnë përdoruesve blerjen, si librari e brendshme në INSTAT, rrjeti i jashtëm i librarive, që INSTAT do të furnizojë drejtpërsëdrejt ose përmes një shpërndarësi, shitja në panairë si dhe përmes komisionerëve, që shërbejnë si ndërmjetësa për shitjen e produktit të INSTAT.

Në politikën e marketingut të INSTAT është punuar kryesisht për dizenjimin e produktit, caktimin e çmimeve si dhe për mënyrat e shpërndarjes dhe të promovimit. Kriteret kryesore për caktimin e çmimeve janë interesi për të rritur përdorimin e informacionit statistikor, cilësia e shërbimit statistikor, si dhe përpjekja për të arritur mbulimin e kostos së produktit.

Megjithatë, në politikën e institucionit përdoren zbritje çmimesh për publikimet periodike, për të stimuluar përdorimin e informacionit statistikor, si dhe një pjesë e konsiderueshme e informacionit të kërkuar sigurohet falas.

Gjithashtu, duke dashur t'i shërbehet sa më mirë përdoruesit me qëllim sensibilizimin e tij, konsultimi i botimeve pranë INSTAT bëhet falas.